

NEXHAT HAKIU

BIBLIOTEKA
SHETIT

854-1

H 20

poema



814-1

H20

NEXHAT HAKIU

NE GARE
ME
STINET

poema:



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

GJERGJ KASTRIOTI

SKËNDERBEU NË NISH

I.

Natë nëntori ish,
kur ti, shpres'e Muratit,
u nise për në Nish.
I qeshur hipe âtit,
me trimat arbër pranë,
kur urdhërin të dhanë...

Kjo era në nëntor,
me yje dhe me hënë,
përplasesh në krahor,
po ty të kishte rënë
një nur, se po mendoje
vatanin ta shpëtoje...

Lavdia për sulltanin:
ish turpi për vatanin!...
Ndaj zemrën ty ta brente

zëri për Arbërinë,
dhe mendjen nuk ta blente
kushtrimi për Turqinë!
Atë që vjete, fshehur,
askujt nuk ia tregoje,
çdo çast ti e mendoje...

Kjo nata e nëntorit
të bëri ëndërrimtar
dhe troku i taborrit
me arbër luftëtarë
ta shtoi ëndërrimin
kur pe ti perëndimin
e hënës-hark buzmalit.
U ndal ky trok i kalit,
se pe sikur kish rënë
flamuri gjysmëhënë,
sikur në majë shpate,
te kull'e Krujës sate,
valonte, pa taborr,
flamuri dykrenor!...
U dha në çast kushtrimi,
t'u pre ty ëndërrimi.

Kjo nata e nëntorit
u nxi u bë mavri
e klithmat e taborrit

si ujq në lukuni
gjëmuan për në Nish,
por Iskënderi s'ish...

Taborret osmanllinjë
me plag' e gjak në brinjë,
tërhequr, lebetitur,
kufirit patën mbërritur:
kërkonin Iskënderin,
mburojën, zulmën, nderin!

ÇLIRIMI I KRUIJËS

Kur Krujën ti e more,
ashtu siç qenë n'arë,
me drapër e kosore,
u sulën kush më parë,
se thirrja jote ishte
kushtrimi i lirisë...

Sa hije ty të kishte,
o trim i Arbërisë,
kur vet' e dhe kushtrimin,
kur ftove trimat pranë
për besën që të dhanë!
Vasalë e tradhtarë
u fshehën sa më parë
se ende për sulltanin
e mbanin jataganin!...

Në krah të Aranitit,
Moisiut me arbëreshë,
mes besës trimëreshë,
qëndroje si shqiponjë,
që krahë, sqep e thonj
tek arbërit i gjen,
tek arbërit që dinë

të maten me rrufenë,
ta mposhtin dhe stuhinë!..
Në bor' e në stuhi,
me trimat që ti pate,
u nise si dragua...
Nga dridhja e pallës sate
Petrela u dorëzua,
Petralbën dhe Tornaçin,
së bashku me Stellushin,
i more ti, pa gjak,
ashtu si Sfetigradi,
që ra si zog në lak,
kur shpejt u bë rrethimi
nga Moisiu, trimi...

O Arbër, Gjergj Kastrioti,
nga gazi dridhesh loti!
Ish mbledhur në qepalla
ky loti, mot pas moti,
kur shtiza edhe palla
që mbanin osmanllinjte
përgjaku dhe kërthinjtë,
kositi gjith' kallinjte...

Në kopshte, në arë,
me belin, ushtën pranë,
pret arbri sa më parë:

kushtrimin në çdo anë...
Ja, arbri, trim me fletë:
Gjergji i Kastriotit,
me kryetrimat flet;
«Liria s'është' e shortit,
do lidhjen, trimërinë,
do besën e urtësinë!..»

BETEJA E TORVIOLLIT

Ç'jan' ata që hedhin vallen
buzëgaz e syrin-pishë,
që s'lëvizin as qepallën,
kur del gjaku mbi këmishë?

Njëri dré, tjetri shqiponjë
përmbi shpatat po kërcejnë,
me topuzë dhe me thonjë,

Nga qeleshet zbardhëllon
fush' e vogël e Torviollit...
E si, vallë, kush lufton
me trimosha t'Anadollit?
Si luftoka arbri ynë
mes mejdanit, pa mburojë,
mes shigjetash kush po hyn,
osmanllinjë t'i sulmojë?

Zbardhëllon e skuq Torviolli,
breshërojnë dhe shigjetat,
nga shtatorja seç na dolli
Ali Pasha me trumbetat!

Disa zbrapsen, shumë shtrihen,
ca po ikin me rrëmbim,
ulërima, kuje ndihen
hingëllima dhe mallëkim!...
Duar, krahë edhe krerë
flakëriten nëpër erë,
trupa jeniçerësh, kuaj
shtrihen sheshit posi duaj!...

Po në gardën, lëmsh në mes,
Ali Pasha ka qëndruar,
s'i ka mbetur fije shpresë
kur sheh turqit shpartalluar!
N'atë lëmsh një shpat' e madhe
vezullon posi llambadhe,
anës tij palla të tjera
çpojnë kuaj, presin krera...
Qënka shpata e Kastriotit
që po vret edhe po pret!...
Ali Pasha i lutet zotit
ndihmën do e po thërret,
osmanllinjve, nga syt' këmbët,
po iu dridhen leqet, dhëmbët!...
Arbër, bré, ju lumtë dora,
si gjithmon' ia bëni fora!
E tani që prijësin keni

dhe luftoni për vatanin,
me lavdinë ju do jeni
edhe turpi me sulltanin.
Mbi kufomat e Turqisë
prin Flamur' i Arbërisë!

RRETHIMI I KRUIJËS

Arbri një, turku njëzetë.
Arbri vetëm me shigjetë,
Turku topa edhe pallë,
e kush do fitonte, vallë?

E kujt zulma i ka hije,
ndonëse Kruja e rrethuar,
cilin vdekja si një hije
vjen me mall për ta pushtuar?

E kush duhet të jetojë,
e kush duhet të fitojë?

Kjo çudia ngjan përrallë,
trimëria: mrekullë,
s'qenka Gjergji trim i rrallë,
paska mij'ra si ai!...

Në çdo hap një turk i vrarë,
në kalà s'po merret haku,

një rrethim i till s'është parë,
po nga cilët rrjedh ky gjaku?

Cilët janë të rrethuar,
arbrit në kalâ plot bujë
apo turqit të hutuar
jasht' kalasë, në Fushë Krujë?

Nga po vjen kjo e goditur,
e çuditshme, e papritur,
anës, mbrapa dhe në ballë
me shigjeta dhe me pallë?

Ç'ka sulltani që tërbohet?
Vrana Konti nuk dorëzohet,
Gjergji s'duket asgjëkundi,
osmanllinjte kush i mundi?

Tri her' Kruja qe rrethuar,
hijerëndë pat qëndruar,
nga marazi dhe nga frika
shpejt Muratit i ra pika!...

As sulltan Mehmeti vetë,
me dredhi e tradhëti

nuk fitoi, mbeti shkretë
peng në zemër Kruja i mbet!...

Tradhëtari Ballaban,
poshtërsit' me venecianë,
nuk e mposhtën Kastriotin,
kryetrimin, kryezotin!...

Printe Flamur' i Arbërisë
mbi kufomat e Turqisë!

VDEKJA E GJERGJ KASTRIOTIT

Si një lis përdhe i shtritur
nga rrufetë i pasfilitur
dergjesh Gjergji n'atë shtrat
me sy ngulur përmbi shpatë,
kur erdh lajmi se taborrë
nëpër malet me dëborë
prap' Mehmeti kish dërguar,
Shkodër, Lezh' për t'i pushtuar!

Buzëgaz e syvenitur,
zemërzhgabë, trupdrobitur,
po mendonte për kushtrimin
e të ngrihesh për luftimin;
u përpoq ta linte shtratin,
po s'lëvizi dot as shtatin
dhe me sytë e mjegulluar
dufin shfryu, dëshpëruar;
dhe nga mllefi u bë dyllë
se i dergjur, i sëmurë,
shihte shpatën prap' në myll,
varur pranë tij në mur.....
Her' e parë kryetrimin
s'po e shohin në luftimin!...

Garda e tij, për her' të parë,
po lufton pa kumandar,
me malsorët krah për krah,
po lufton e po fiton
osmanllinjtë po dërrmon...


Po kur lajmi i fitores
nëpër bor' e nëpër brymë
erdh' në Lezhë me fërtymë,
Gjergji s'merрте dot as frymë,
veç buzëqeshi për lavdinë,
se lirin' e trimërinë
siç i gjeti, prap' i la...

DASMË NË STAN

— Dale-dale, Vankë,
Vankë, moj çobankë,
sa ma kënda mua
në gjurmët e tua,
ndaj po shkel tani
që tek ty të vi,
Vankë, sa të dua!

Qëkur me rininë
në aksione ishim,
lidhëm miqësinë,
po diçka të fshehtë
në zemër ne kishim...

Tezgën me zhavor
mbanim dor' për dorë,
shiheshim në sy,
me sa turp e frikë,
fjalosnim të dy,
her' me vend, her' kot,
po me zemrën plot
veç s'e thoshim dot



12553

fjalëzën: «të dua» ...
N'atë çast të dy
ulnim ata sy,
oh, sa turp për ty,
oh, sa turp për mua!
Vetëm kur në krua
shkonim prapë të dy
të ngacmoja ty:
«Vankë, moj çobankë!»
aty për aty
ma shpërbleje, Vankë:
«Lushi, veshllapushi»...

Qëkur s'të kam parë,
malli më ka marrë,
të ngrysem në stan,
me ty në tëbanë,
dale-dale, Vankë,
Vankë, moj çobankë!

II

— Mirë se vjen, o mysafir,
ore Lush, o veshllapush!

— Vankë, mirë se të gjej,
Vankë, Vankë moj Çobankë!

— Qenke nisur pagdhirë,
e ç'të solli ty këtej?

— Erdha kot sa për të parë,
në se puna ju shkon mbarë
me kopet' e me stanarë!

— S'ka më mir', o mysafir,
kur bashkohen gjith kopetë,
gjalpi: lum', qumështi: det,
djath'i njomë stivë-stivë,
s'ka si kjo kooperativë!...
Lum e lum si ne tani
me kullota e vërri,
plot me vathë e me stalla,
s'kemi më ato andralla,
as në fshat e as në stan,
siç i patën prindërit tanë!...
«Brree, jo tutje, shytkë, brree!
Oj-oj, laragâne, oj,
edhe ti azgëne, moj,
shpejt te shoqet në kope!...»

— Qënke, moj, deli bareshë,
mir' e ditke dhe zanatin,
e sa shpejt të marrkan vesh,
lum për dhëntë, lum për fshatin,
lum ai që do të marrë,
do t'i shkojë jeta mbarë!...

— Qëkur isha kalama,
nëna kërrabën shpejt më dha,
me një dele, me dy dhi,
nëpër diell, nëpër shi,
vetëm filli, pagdhirë,
kthehesha në mugëtirë...

— Po nga ujku s'kishe frikë?

— Jo, ky ujku nuk më tremb,
veç nga ujku me dy këmbë,
edhe sot që jam e rritur,
shkoj me frikë dhe mërzitur...

— Paske frikë nga bandillat,
kur fërshëllejnë si bilbilat,
kur të pret ndonjë delmer,
kësulhumbur, mëngëçjerrë!

— Lëri, Lushi, këto fjalë,
ti, këtej, përse ke dalë?

— Vankë, malli më ka marrë
për kopë e për stanarë;
më pëlqen kjo jetë e stanit,
edhe guna e çobanit...

— S'të pëlqeka më traktori,
pasje mendjen te përçori...

— Jo, moj Vankë, jo, moj, jo!
Dua të rri me sharanin,
dhe përherë të shoh
desh' e qingja, kur mburriten...
Po me kërrabën e çobanit
t'i kap qingjat, kur të rriten...
E pastajza, me ty pranë,
të pushojmë në tëbanë,
me baresha, me çobanë!...

— Ik, o Lush, pa shihe dhinë,
si mërzen e si kërcen,
bëbullon e vetëtin,
ik, se shi i madh po vjen!...

— S'jam sheqer që të shkrihem,
edhe breshër le të bjerë,
se te guna jote fshihem
është' e gjatë dhe e gjërë...

Iku Vanka aty pranë,
ndën një lis, mbi sharavaze,
dhe me qingjin laraman,
luante, qeshte me sa naze...
Ndërsa Lushi përmatanë
ishte futur në koriye
e me hije dashurie
po dhëmbkoste një zambare,
që t'i binte dhe për Vankën,
për çobankën kanakare...

U nis Vanka me kopenë
lart në vathë, në tëbanë,
është koha kur po vjen
çobanbashi për në stan,
kur barinjtë me stopanë
ndezin zjarre në çdo anë,
mjelin qumështin delmerët
nëpër vedra, në vegjore...

E sa nisi që të erret,
nëpër pllaja e bregore,

ndihej zër'i një zambare
për çobankën kanakare...

III

Atje lart në stan
ftuar nga çdo anë:
barinj dhe baresha,
stopan, stopanesha,
delmer' e lopçarë
këngës ia kan' marrë...

Çobanbash' i parë
e nis vallen shtruar,
vallen vet' i dytë,
nusja ulur sytë
shkel e turpëruar...

Atje lart në stan
zjarri malja-malja,
nus' e dhëndër pranë,
hidhet, lidhet fjala...
Gaze dhe shaká,
çifti u trashëgoftë,
çifti me sevdá
këmbën heqte zvarë
për të rinjtë stanarë...

Dasma me dolli,
défi po kërcet,
fyelli me gërnetë
dhe qermania vetë,
që të gjith' në garë
këngës ia kan' marrë
se kërcen tani
vetëm çifti ri...

«Dridhe, Vankë, dridhe,
Vankë, dridhe vallen,
mos ma ul qepallen!...
Hidhe, Lushi, hidhe,
dridhe dhe përdridhe
vallen në tepsi,
se na more Vankën,
Vankën si hyri!...»

Blegërijnë dhëntë,
hamullijnë qëntë,
dy delmerë rrinë,
rrinë dhe përgjojnë,
ujqërit mos iu vijnë
dhe kopet' sulmojnë...

E ndaj të gdhirë,
dasma kur mbaroi,

Vanka, kjo çobanka,
me Lushin na shkoi...
Zbritën posht në fshat,
në shtëpin' e re,
urimet të presin
nga çobanëria
e nga krushqia...

Brinjës tatëpjetë
Lushi me çudi
Vankën prapë pyet:
— Kur të bjerë shi,
Vankë, moj çabankë,
do më mbrosh në gunë,
se këtej e tutje
nuk të prish më punë?...

— Jo, Lush, veshllapush,
do të lë në shi,
të lagem më shumë,
nuk të qas në gunë!...

— Vankë, moj çobankë,
e po në aksion,
ashtu si gjithmonë,
bashkë do punojmë?...

— As atje, o Lush,
po më pyeti kush,
me ty do kërkoj
që të jem në garë:
kush të dal' i parë!...

Brinjës tatëpjetë
mbi lëndinë shket
Vanka, kjo çobanka,
duke përgëzuar
qingjin, sylarushin,
që s'e la në stan
dhe në gji e mban...

Vanka po përgjonte
edhe qeshte fshehur,
Lushi ishte nxehur,
Vanka u gajas,
u gajas nga gazi,
Lushi ecte pas
fryrë nga marazi,
se kjo Vanka luan,
qesh me sylarushin
dhe harroi Lushin!...

Lushi pik' e vrer
thirri dhe një herë:

— Dale-dale, Vankë,
pritëm, moj çobankë,
prapë ma kënda mua
në gjurmët e tua
të shkel dhe tani
e me ty të rri...
Vankë, sa të dua...!

NË GARË ME STINËT

O diell i jetës n'atdheun tim,
sa është' i zbetë
ky vargëzim,
kur shkrep ti vetë
mbi rruzullim!...

Sikur me ngjyrat në prag të stinës,
me zën' e ëmbël të kanarinës
të vargëzoja
edhe me rrezet, që çdo mëngjes
ngrohin burbuqet e thithin vesë,
t'i ngazëlloja
vargjet e mia,
nuk do t'arrija
as te kjo hija
e bukurisë n'atdheun tim!...

Ky vargëzim,
ndonëse i zbetë, merr frym' e jetë,
kur i këndon jetës-stoli,
njeriut të ri...

I

Po gurgullon...

Nga maja e malit bora po shkrin,
burimet shkasin ndër fije bari
dhe n'ato lule që vetë mbijnë,
rrezet mbi 'to tani po ndrijnë
si fije ari...

Po gurgullon...

Kudo bleron,
si arabeska degët-stoli
po vezullojnë.

Pranver' e qeshur!

Shokë dhe shoqe, ja përsëri,
dheun e ngjeshur
po shkrifërojnë

te toka e re.

Dhe ja përse

po ajo dorë,

që di të mbjellë, që di të korrë,

nuk ka ç'të presë:

fidanin, që vetëm me vesë

e pat vaditur,

e mbjell me diell,

farën e parë hedh në ugarë,

çan edhe plisat, duke prashitur...

Po gurgullon...

Ugaret, plisat po kundërmojnë,
trumcakët prapë po cicërojnë,
një avull ngrihet, se përtërihet
tok' e punuar, që me shkëlqim
po çel burbuqe dhe gjelbërim...

Prapë buçet

kjo uturima e traktorëve
dhe blegërima e përçorëve:
i mbajnë ison këngës së punës,
se kjo rinia në çdo aksion,
si bukurisë
dhe begatisë

stolit' ia shton...

Po gurgullon...

Kjo dallëndyshja folen ndërton.

Pranver' e bukur, veç lule, fletë,

do edhe jetë...

II

Nuk gurgullon...

Nga gropa e malit bora ka shkrirë,
rrëketë më nuk po rrëshqasin,

kallinjtë rriten edhe vaditen
me rezervuar,
veç dielli djeg si saç me zjarr...

Pu-pu gjinkalla si cinxërit,
flutura e shkruar u përpëlit,
njerëz dhe shpendë hije kërkojnë,
veç vetëm bletët

në zheg punojnë
thithin nektar...

Kokrrat u fshehën në degë, fletë
se dielli-zjarr ka për t'i tharë.
Vera për vete nuk po i mban,
me motrën, vjeshtën, ajo i ndan...

O ç'thatësi, ç'farë zagushi,
pika e shiut do t'ish flori!
Po gruri ynë nuk mund të digjet,
as kokrrat tona nuk mund të thahen,
se motit ne ia ndërrojmë ligjet:

shkëmbinjtë çahen
nga kjo rinia, diell e stuhi:
po gurgullon burim i ri...

E në shterroftë burim' i ri,
prap' kjo rini

dorë për dorë, vargan-vargan,
po me bucela ujin e mban:
kallinj e pemë prap' i vadit,
se edhe natën e bëri ditë...

Në vend të hënës spërkati dritë
ky projektori,
djersa ndriçon te krahërori,
djers' e korrikut, bulza flori,
që natën ndrin porsì kalli,
e po freskon ball' e krahror,
se ajo dorë
që di të mbjellë, që di të vjelë
edhe të korrë,
stivosi duart dhe prap' vadit
e po prashit...

III

Nuk gurgullon,
veç vetëtin e bubullin,
kënga dëgjohet,
kudo prarohet ...

U volën kokrrat, gjethet po bien,
dimri në kreshta flokët e thinjur po na rrëfen...

Por ajo dorë,
që di të mbjellë, që di të korrë,
që voli kokrrat fshehur në fleta,
po hap ugarë...

Ashtu si bleta, që mjaltin mban zgjua më zgjua,
fidan e farë

i ka ormisur, po ajo dorë,
që ta stolisë dimrin me borë...

Kënga dëgjohet,
kudo prarohet...

Gjethet e fundit, ja, një nga një,
bien si kokrrat, pa bërë zë...

Ajo-Ai: një çift i ri,
për 'ta të gjithë ngrehin dolli,
krushqit këndojnë e po vallëzojnë...

Dhe ja tani, po ajo dorë,
që di të mbjellë, që di të vjelë
edhe të korrë,
shamin' e valles tund në dasmorë...

IV

Po bije borë...
Plakut, ndonëse me xhoken e veshur,
i dridhet buza,
po me lopatën që mban në dorë,
hap shtigjet, rrugët, mbushur me borë...
Shoqes, që luan me topa ngjeshur,
i njomet bluza,
por syt' i qeshën, i qeshi buza,
kur shkundi degat me borë veshur...

Po bije borë...
Brenda dritares shoqja sodit...
Ajo sodit dhe shton stolitë,
se tok me shoqe edhe me shokë,
ngricën e çau, që shpejt të shkrihet,
që prap' kjo tokë
të përtërihet...

Pra' bije borë...

Flokët mbi akull në çast po ngrijnë
dhe presin diellin që shpejt të shkrijnë,
t'i thithë toka që si burim
të gurgullojnë dhe për verim
nga kresht' e malit të kenë zbritur:
ara dhe vreshta për të vaditur...

Por ajo dorë

që di të mbjellë, që di të vjelë
edhe të korrë,
që për dorashka mban flokë borë,
nuk priti diell,
me bulza djerse e pati shkrirë
ngricën mbi dorë,
se dhe në dimër i shton stolitë,
kur prapë mbjell edhe krasit...

Nuk bije borë...

Degët po duken si arabeska
bardhë e zi,
se floku i borës në dega ngel
e ngjan si gonxhe që porsa çel...
Po-po si gonxhe që shpejt prej erës,
erës së vakët, ka për t'u shkrirë:
në vend të saj ka për të mbirë
gonxhja e parë e pranverës...

*
* *
*

Me ju, o stinë, në garë jemi
përgjithmonë,
kështu çdo vit ne do t'ju kemi:
pranverën tonë...

Se ja këtu, n'atdheun tim;
ku diell' i jetës po rrezëllin
mbi bukurinë,
çdo shkëmb e gur, çdo driz' e ferrë
jetë po merr...

Këtu dhe femra është si burri,
këtu dhe plaku është përtëritur,
këtu pionieri shpejt qenka rritur,
këtu-këtu
shtratin braktis dhe i sëmuri!...

Këtu-këtu,
ku gjaku u derdh deri në gju,
ky amaneti nuk shuhet kurrë,
se po valon dhe në flamur,
se vezullon te lapidari,
se është zemra e çdo shqiptari!

*
* *
*

...Vargun ndërpres, se poezinë
e gjej në garë e në çdo stinë,
kur si jehonë

dëgjoj kudo:

Këngën e djersës, himnin e ri
për ty, Parti;

për bukurinë

që po krijon n'atdheun tonë
njeriu i ri,

që po marshon,

dhe ajo dorë

që di të mbjellë, që di të vjelë
edhe të korrë...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Gjergj Kastrioti	3
Dasmë në stan	17
Në garë me stinët	28

Tirazhi 1000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

SHTYPUR: KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1977